



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Zyra e Rregullatorit për Energji shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i departamentit të tregut të energjisë
Klasa e pozitës	Drejtues i Mesëm 1
Koeficienti/Paga	Fix-1340
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	16/11/2021
Afati për aplikim	01/12/2021 - 08/12/2021
Institucioni	Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti	Departamenti i Tregut të Energjisë
Divizioni	
Vendi i punës	
Nr. i Referencës	RN00007887
Kodi	RPC0001695



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Udhëheqësi i Departamentit të tregut të energjisë menaxhon me Departamentin e Tregut të Energjisë dhe është përgjegjës për analizimin e çështjeve të strukturës së tregut, zbatimin e elementeve të konkurrencës së pjesëmarrësve në tregun e sektorit energjetik në Kosovë, me qëllim që të shmangen sjelljet kundër konkurrencës dhe abuzimet në rastin e monopolit në sektorin energjetik të Kosovës.
- Ajo / ai analizon strukturën e tregut, bilancin energjetik, kapacitetin dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në të gjitha segmentet e industrisë energjetike. Ajo / ai propozon masa për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike dhe monitoron zbatimin e rregullave të tregut. Ajo / ai do të ndihmojë në përgatitjen e legjislacionit në lidhje me promovimin e një tregu konkurrues të energjisë bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës dhe jo diskriminimit. Departamenti i udhëhequr nga ajo / a i bashkëpunon ngushtë me Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave të ZRRE-së, për të siguruar përputhshmëri të duhur të modeleve të tregut, metodave të analizimit të dhënave, strukturave të kostove të ngjashme dhe strukturave tarifore.
- Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si më poshtë:
- Analizimi i tregut të energjisë, i sistemit energjetik dhe furnizimit me energji
- Pajtueshmëria me rregullat e dizajnit të tregut
- Sqarime dhe ndihmë në procesin legjislativ sa i përket strukturës së tregut
- Zhvillimi i sistemit për monitorimin e tregut
- Monitoron tregun me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike dhe kujdeset për zbatimin e parimeve të tregut
- Monitoron zbatimin e detyrimit të transparencës prej të licensuarve;
- Kontrollon parashikimin e kërkesës dhe bilancit të kapacitetit të të licensuarve.
- Përgatitë analizën e kërkesave për çështjet e sigurisë së sistemit energjetik Mbledhë informata dhe analizon raportet nga gjeneratorët dhe prodhuesit në lidhje me daljet nga puna
- Përgatitë kërkesat për sigurinë e rrjetit të transmisionit (kriteret, numri dhe kohëzgjatja e daljeve nga puna, energjia e pa furnizuar)
- Merret me pyetjet që kanë të bëjnë me teknologjinë energjetike
- Merret me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit sa i përket tregut energjetik
- Mbështetë menaxhimin e kërkesave dhe programeve për kursimin e energjisë

Pajtueshmëria me rregullat e dizajnit të tregut

- Monitoron zbatimin e Rregullave të tregut, dhe kodeve të Operatorëve të Sistemit të Energjisë Elektrike;
- Ofron ndihmë për ndërmarrjet energjetike gjatë përgatitjes së kodeve të transmisionit dhe të shpërndarjes dhe jep këshilla për Bordin e ZRRE-së në lidhje me miratimin, rregullimin apo mosmiratimin e kodeve
- Siguron qasje jo diskriminuese në rrjetet energjetike dhe monitoron keqpërdorimin potencial të monopoleve natyrore
- Shqyrton elementet e strukturës së tregut si dhe ristrukturimin që ndërlidhet me punët përgatitore të industrisë energjetike
- Në bazë të kërkesës nga Ministria përgjegjëse për energji, jep këshilla për strategjinë e energjisë si dhe programet për zbatimin e strategjisë.

Sqarime dhe ndihmë në procesin legjislativ sa i përket strukturës së tregut

- Jep sqarime dhe këshilla në lidhje me sistemet energjetike, lidhjet për furnizim me energji, strukturat e tregut, teknologjitë energjetike dhe çështje të ngjashme
- Ndihmon në përgatitjen e legjislacionit në lidhje me procedurën për zgjidhjen e kontesteve si dhe çfarëdo legjislacioni tjetër të cilin ZRRE ka të drejtë ta nxjerrë në lidhje me strukturën e tregut.
- Bazat e të dhënave dhe monitorimi i tregut
- Përgatit raporte vlerësimi për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, përfshirë procedurat e blerjes së energjisë elektrike, planeve të investimeve dhe marrëveshjeve të pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike;
- Monitoron Operatorin e Tregut mbi zbatimin e legjislacionit që lidhet me Tregun e Energjisë elektrike;
- Grumbullon të dhëna dhe informacionet e nevojshme nga pjesëmarrsit e tregut dhe të licensuarve të sektorit të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore, etj.



- Në përputhje me gjetjet e monitorimeve, përgadit informacione për Bordin, përfshirë rekomandimet përkatëse ;
- Propozon ndryshimin ose amendamentimin e Rregullave të Tregut dhe akteve tjera që lidhen me tregun e energjisë;
- Analizon sjelljen e ndërmarrjeve energjetike në treg
- Analizon efektin e rrethanave të ndryshme në çmimet e tregut
- Krijon dhe menaxhon sistemin monitorues të çmimeve të tregut
- Çdo detyrë tjetër të caktuar nga mbikëqyrësi i saj / tij.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë universitare në ekonomi, apo inxhinieri elektrike
- Njohje e mirë e sistemit energjetik të Kosovës dhe rajonit më të gjerë të Evropës Juglindore
- Njohuri për Direktivat e zbatueshme të KE-së dhe për strukturat e tregut energjetik në nivel ndërkombëtar
- Të paktën 5 vite përvojë pune relevante
- Njohje e punës me kompjuter
- Njohuri të punës me programet Microsoft Office;
- Njohja e shkëlqyer e njërës gjuhë zyrtare është obligative dhe njohja e gjuhës së dytë zyrtare është e dëshirueshme;
- Njohja e mirë gjuhës angleze është e obligueshme;
- Shkathtësi të fuqishme menaxhuese dhe drejtuese, sikurse krijimi i ekipit, motivimi i njerëzve dhe nxitja e ndryshimeve
- Aftësi për përcaktimin e drejtimeve strategjike
- Aftësi për punë efektive në mjedis shumë etnik dhe shumë kulturorë
- Aftësi për të punuar me nivelin më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe formulim politikash;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Njohuri të gjera lidhur me fushën e përgjegjësisë së departamentit;

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit;
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende;

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 15/12/2021, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 16.12.2021, ZRRE

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

